



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 mars 2021
Nr.ref.:RK 1736/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI62/20

Parashtrues

Gekos Sh.p.k

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit ADGJTHP.nr. 4/20 të
Gjykatës Themelore në Prizren, të 11 marsit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Driton Shuku, drejtor i Gekos Sh.p.k me seli në fshatin Lapna Selë, komuna e Graçanicës, të cilin e përfaqëson avokati Korab Bokshi nga komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [ADGJTHP.nr. 4/20] e 11 marsit 2020, të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Vendimi i kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, me të cilën pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 prill 2020, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka Nimani.
7. Më 28 maj 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së punës kërkoi nga ai që plotësojë formularin dhe ta dorëzojë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.
8. Më 10 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi formularin për paraqitje të kërkesës në Gjykatë, si dhe autorizimin përkatës për përfaqësim në Gjykatë.
9. Më 19 tetor 2020, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Prizren.
10. Më 10 dhjetor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi rastin dhe vendosi që rasti të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e radhës, me kërkesë që i njëjti të plotësohet.
11. Më 24 shkurt 2021, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës konsiston që rasti kishte të bënte me një rast të pengim posedimit në të cilin ishin palë parashtruesi i kërkesës dhe personi i tretë Xh.Zh.
13. Më 9 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktvendimit [C. nr. 335/11], miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës "GEKOS" Sh.P.K. duke vërtetuar se pala e interesuar Xh. Zh., me 20 korrik 2011, e ka penguar parashtruesin e kërkesës në gjendjen e fundit faktike të posedimit dhe shfrytëzimit të lokaleve të cilat gjenden në lagjen Sefë në Gjakovë [...], në mënyrë që me kanosje dhe nën kërcënimin e armës ka ndikuar që parashtruesit të kërkesës të ia heqë posedimin e lokaleve, ashtu që detyrohet pala e interesuar Xh.Zh. që në afat prej 48 orëve pas marrjes së këtij aktvendimi, të ia kthen në posedim parashtruesit të kërkesës lokalet e cekura me lartë dhe në të ardhmen të përmbahet nga pengimi i këtillë apo i ngjashëm, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.
14. Më 14 prill 2016, përmbaruesi Privat Gj.R përmes Urdhrit Përmbarimor [P.nr.197/16] lejoi përmbarimin në bazë të titullit përmbarimor –Aktvendimit [C.nr.335/11] të 9 shkurtit 2016, të Gjykatës Themelore në Gjakovë.
15. Më 21 prill 2016, pala e interesuar Xh. Zh parashtroi prapësim kundër Urdhrit Përmbarimor të lartcekur, për shkak të (i) shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe Përmbarimore; (ii) për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 5 maj 2016, parashtruesi i kërkesës në cilësi të kreditorit, parashtroi përgjigje në prapësim, ku propozoi që prapësimi i palës së interesuar, përkatësisht debitorit, të refuzohet si i pabazuar.
17. Më 20 shtator 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë përmes Aktvendimit [PPP. nr.90/2016]: (i) refuzoi si të pabazuar Prapësimin e palës së interesuar Xh.Zh., të ushtruar kundër urdhrit të përmbaruesit privat Gj.R. mbi lejimin e përmbarimit [P.nr. 197/2016] të 14 prillit 2016; (ii) mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat Gj.R., mbi lejimin e përmbarimit [P.nr. 197/16] të 14 prillit 2016; (iii) Ankesa kundër këtij aktvendimi, nuk e ndalon procedurën përmbarimore, përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 [Garancitë për ankesa kundër vendimit lidhur me prapësimin për një kredi në bazë të dokumentit të besueshëm] të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin në vijim: LPP).
18. Më 3 tetor 2016, pala e interesuar parashtron ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur, ndërsa më 7 prill 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3959/2016] refuzoi si të pabazuar ankesën e debitorit Xh.Zh. dhe vërtetoi Aktvendimin [PPP.nr.90/2016] e 20 shtatorit 2016, të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

19. Më 26 korrik 2019, Përmbauesi Privat Gj. R. përmes Konkluzionit [P.nr. 197/16] obligoi palën e interesuar Xh.Zh. që deri më 27 gusht 2019, të bëjnë lirim të paluajtshmërisë nën kërcënimin e përmbaimit të dhunshëm.
20. Më 26 gusht 2019, pala e interesuar Xh.Zh. parashtron kërkesë për përjashtimin e përmbauesit privat Gj.R., ndërsa me 10 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë përmes Aktvendimit [PPP.nr. 235/2019] hodhi poshtë si të pa lejuar kërkesa e debitorit Xh.Zh. me të cilën kishte kërkuar diskualifikimin (përjashtimin) e përmbauesit privat Gj.R., që të procedoi sipas urdhrit përmbaimit [P.nr.197/2016] të 14 prillit 2016. Vlen të theksohet që pala e interesuar Xh.R. të njëjtën kërkesë për përjashtim të përmbauesit privat Gj. R, e kishte bërë edhe me 7 shtator 2017, të cilën Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr. 47/2018] të 11 majit 2018 e kishte hulumtuar poshtë si të pabazuar.
21. Në një datë të pacaktuar, pala e interesuar Xh.Zh. parashtoi propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, pasi që përmes kërkesëpadisë kishte kërkuar anulimin e Vendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, i cili u bë i plotfuqishëm dhe se për të njëjtin ishte duke u zhvilluar procedura përmbaimore tek përmbauesi privat Gj.R.
22. Përderisa, në një moment në këtë rast, ka qenë i involvuar edhe gjyqtari i Gjykatës Themelore në Gjakovë, z. D.H., Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktvendimin [CN.nr.109/17] e 29 shtatorit 2017, caktoi Gjykatën Themelore në Prizren si gjykatë kompetente për shqyrtimin e këtij rasti.
23. Më 13 nëntor 2019, Gjykata Themelore në Prizren përmes Aktvendimit [C.nr.1330/17]: (i) aprovoi si të bazuar propozimin e paditësve Xh.Zh dhe R.Zh, për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë me të cilën urdhërohet parashtruesi i kërkesës, Gekos sh.p.k, me pronar Driton Shuku, ashtu që urdhërohet përmbauesi privat Gj.R. nga Gjakova, që menjëherë të pezullojë procedurën e përmbaimit [P.nr. 197/16], dhe i ndalohej çfarëdo veprimi në procedurën e përmbaimit me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese, dhe atë duke i ndaluar që të ndryshohet gjendja faktike në posedim dhe shfrytëzim të lokaleve;[...] (ii) Kjo masë e sigurimit mbetet në fuqi deri në vendosjen meritorie të kësaj çështje juridike apo deri sa gjykata të vendos ndryshe lidhur me këtë masë.
24. Më 2 mars 2020, nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesi i kërkesës bazuar në paragrafin 3 të nenit 9 (Ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkelje disiplinore) të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kishte parashtruar ankesën tek Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren, kundër Gjyqtarës të Gjykatës Themelore në Prizren, E.S, lidhur me caktimin të masës së përkohshme të sigurisë përmes Aktvendimit [C.nr. 1330/17] të 13 nëntorit 2019, të Gjykatës Themelore në Prizren. Të njëjtën ankesë, parashtruesi i kërkesës e kishte parashtruar edhe tek Avokati i Popullit, e cila i ishte përcjellë Gjykatës Themelore më 6 mars 2020.
25. Më 11 mars 2020, Gjykata Themelore në Prizren, përmes Aktvendimit [ADGJTHP.nr.4/20] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të

kërkesës, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës E.S. parashtruar te Avokati i Popullit në Prishtinë më datë 02 mars 2020.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjyqtarja E.S, ka bërë shkelje të pa “presedan” në praktikën gjyqësore me vendosjen e masës së përkohshme përmes Aktvendimit [C.nr.1330/17] i 13 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore në Prizren. Sipas parashtruesit është e pashpjegueshme se si Gjykata e nivelit të njëjtë, përkatësisht Gjykata Themelore në Prizren vepron sipas padisë së palës së interesuar Xh.Zh. që të anulohet vendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, dhe ndalon ekzekutimin e vendimit gjyqësor të plotfuqishëm dhe përmbarimor.
27. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që kanë paraqitur kundërshtim ndaj Aktvendimit [C.nr.1330/17], mirëpo gjyqtarja me arbitraritet nuk ka vepruar konform Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin në vijim: LPK), “nuk e ka caktuar seancën në tri ditët e ardhshme.”
28. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon që arsyetimi i Vendimit të kontestuar nuk i është përgjigjur asnjërit nga pretendimet disiplinore. Përfundimisht, parashtruesi thekson që ky Vendim i mohon edhe të drejtën në ankesë.
29. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të (i) anuloj Aktvendimin [ADGJTHP.nr. 4/20] e 11 marsit 2020, të Gjykatës Themelore në Prizren, dhe (ii) të urdhërojë Gjykatën Themelore në Prizren për veprim urgjent në çështjen [C.nr.1330/17] pasi që është shkelur e drejta në gjykim në afat të arsyeshëm.

Dispozitat relevante ligjore

Kushtetuta e Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediejeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Ligji Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

Neni 9

Ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkelje disiplinore

1. Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore tek autoritetet vijuese (në tekstin e mëtejshëm: "Autoriteti Kompetent"):

1.1. Kryetari i Gjykatës Themelore dhe të Apelit në të cilën shërben gjyqtari për sa i përket pretendimeve për shkeljeve disiplinore të atij gjyqtari;

[...]

3. Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori tek Avokati i Popullit.

[...]

6. Autoriteti Kompetent sipas nenit 9, paragrafin 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimi të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12, paragrafin 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar. Lidhur me vendimin e marrë, Autoriteti Kompetent njofton menjëherë me shkrim personin që ka paraqitur ankesë. Një kopje e vendimit i dorëzohet edhe Këshillit përkatës, dhe në rastet e parapara me paragrafin 3 të këtij neni edhe Avokatit të Popullit.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

"[...]"

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

Neni 113

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

33. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastet e Gjykatës, KI10/20, me parashtrues “Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Hidroregjioni Jugor” SH. A. – Njësia Malësia e Re Prizren, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 tetorit 2020, paragrafi 35; rasti KI41/09, parashtruesi i kërkesës Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
34. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [ADGJTHP.nr.4/20] e 11 marsit 2020, të Gjykatës Themelore në Prizren dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) në veçanti përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

36. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [ADGJTHP.nr.4/20] të 11 marsit 2020, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës.
38. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës ankohet se në rastin e tij gjykata e rregullt i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara (i) në nenin 31 të Kushtetutës, pasi që nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, për sa i përket inicimit të procedurës disiplinore për Gjyqtaren E.S., e cila kishte aprovuar si të bazuar propozimin e palës së interesuar Xh.Zh. për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë për pezullimin e procedurës së përmbarrimit [P.nr.197/16]; dhe (ii) Vendimi i kontestuar i mohon të drejtën në ankesë në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës.
39. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së (shih në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. "Shkalla e katërt", paragrafët 262 dhe 263), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "kushtetutshmërisë" dhe "ligjshmërisë" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e

Gjykatës: KI139/19, me parashtrues *Riad Bejtullahu*, Aktvendimi për Papranueshmëri i 3 dhjetorit 2020, paragrafi 56; KI179/18, parashtrues *Belgijzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).

40. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI139/19, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61).
41. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin përkatës (për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e "*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*", shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
42. Gjykata rikujton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata (shih rastet e Gjykatës: KI101/19, me parashtrues *Ljubiša Trajković*, Aktvendim për Papranueshmëri i 4 dhjetorit 2020, paragrafi 43; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
43. Në rrethanat e rastit konkret në ndërlidhje me pretendimin kryesor të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht pretendimit për vërtetim të gabuar të fakteve për sa i përket inicimit të procedurës disiplinore për Gjyqtaren E.S., Gjykata Themelore theksoi si në vijim:

Lidhur me pretendimet e palës ankuese, kryetari i Gjykatës ka zhvilluar një hetim preliminar, ka bërë shiqimin e shkresave të lëndës, C.nr.1330/17, si dhe ka kërkuar informacion nga Gjyqtarja E.S. dhe pasi ka analizuar të gjitha shkresat si dhe ankesën, ka konstatuar se: kërkesa është e pabazuar. [...] Me shiqimin në shkresat e lëndës C.nr.1330/17 është konstatuar se gjykata ka caktuar tri herë rastin për shqyrtim, herën e fundit me dt. 12.11.2019, ku edhe është vendosur për masën e përkohshme të sigurisë, në të cilën seancë nuk ka marrë pjesë përfaqësuesi i të paditurës [parashtruesi i kërkesës] edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt.

Ndaj të njëjtës gjykatëse përfaqësuesi i të paditurës, ka parashtruar kërkesë për përjashtim në vendosja e rastit, me arsyetim se gjykata është e njëanshme, por kryetari i gjykatës me aktvendimin IV.GJA.nr.1/20-1 të dt. 09.01.2020 e ka refuzuar kërkesën si të pabazuar.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka zvarritje të qëllimshme të procedurës, nuk është vërejtë se gjykatësja është e njëanshme apo vepron me tendencë dhe se gjyqtarët në vendosjen e çështjeve janë të pavarur me ligj si dhe fakti se si ka vendosur, nuk është në kompetencë të kryetarit të Gjykatës të ndërhyjë në pavarësinë e vendosjes, por gabimet eventuale përmirësohen në bazë të mjeteve të rregullta juridike, të cilat pala në bazë të ligjit i ka në dispozicion. [...] në të kundërtën do të konsiderohet ndërhyrje në pavarësinë e vendosjes në Gjykatë.

Po ashtu, në bazë të ligjit të Procedurës Kontestimore dhe atë neni 304 pika 1 masa e përkohshme e sigurisë mund të propozohet para inicimit dhe gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor si dhe pas përfundimit të tij, derisa përmbarimi të përfundoj plotësisht, dhe sipas vlerësimit të gjykatësës i padituri në procedurën e përmbarimit është vonuar me parashtrim të kërkesës për përmbarim në afat prej 30 ditësh në kuptim të dispozitës së nenit 482 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe se kjo dispozitë është e karakterit imperativ për të cilin gjykata përkujdeset sipas detyrës zyrtare.

44. Prandaj, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimin e gjykatës së rregullt të shtjelluar më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykata e rregullt mund të ketë "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*" duke rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin e kërkesës, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për vërtetimin e gabuar të fakteve dhe interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm përkitazi me inicimin e procedurave disiplinore për gjyqtaren E.S., kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e "*shkallës së katërt*" dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të "*ligjshmërisë*" dhe nuk janë argumentuar në nivel të "*kushtetutshmërisë*" (shih rastin e Gjykatës KI139/19, cituar më lartë, paragrafi 70).
45. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se në rrethanat e rastit konkret, Aktvendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore, të garantuara me nenin 32 të Kushtetutës, pasi që i mohon edhe të drejtën në ankesë.

46. Fillimisht Gjykata sjell në vëmendje dispozitën e nenit 32 të Kushtetutës ku përcaktohet:

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

47. Gjykata thekson se realizimi i kësaj të drejte, duke përfshirë edhe bazat për shfrytëzimin e saj, rregullohen me ligj. Ky nen plotësohet dhe lexohet në lidhshmëri edhe me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe me praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së.
48. Rrjedhimisht, Neni 13 kërkon që kur një individ ka një pretendim të argumentueshëm për të qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të përcaktuara në Konventë, në ato rrethana ai duhet të ketë një mjet juridik para një "autoriteti" kombëtar në mënyrë që të vendoset kërkesa e tij; dhe nëse është e përshtatshme, të marrë dëmshpërblim (shih rastet e GJEDNJ-së: *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 6 shtatorit 1978, paragrafi 64; *Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 25 marsit 1983, paragrafi 113; *Leander kundër Suedisë*, Aktgjykim i 26 marsit 1987, paragrafi 77 (a)).
49. Megjithatë, GJEDNJ ka theksuar që Neni 13 nuk mund të interpretohet që kërkon një mjet juridik në të drejtën vendore për sa i përket secilës ankesë të supozuar që një individ mund të ketë, pa marrë parasysh se sa jo meritore mund të jetë ankesa e tij: ankesa dhe pretendimi duhet të jetë "e argumentueshme" për sa i përket KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së: *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 27 prillit 1988, paragrafi 52; *Maurice kundër Francës*, Aktgjykim i 6 tetorit 2005, paragrafi 106).
50. Bazuar në parimet e lartcekura, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës nuk është i argumentueshëm, pasi që Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nuk parasheh të drejtën në ankesë, në rastet kur nga autoriteti kompetent (në rastin konkret Kryetari i Gjykatës Themelore) vendoset që ankesa është e pabazuar dhe e njëjta nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore të gjyqtarit. Përfundimisht, e drejta e përdorimit të mjeteve juridike në kontestimin e Vendimit të kontestuar nuk është e përcaktuar me ligj.
51. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë.
52. Si përfundim, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 24 shkurt 2021, njëzëri:

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi